

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data .11.2023

**LENDA: PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Riparimi i transformatorve TL/TM”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Riparime dhe mirëmbajtje impiantesh 45259000-7.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

150,000,000 lekë pa TVSH.

Vlera ne Euro Referuar Kursit të këmbimit – Përditesimi i fundit datë **14.11.2023:** 1.434.171  
(one million four hundred thirty four thousand one hundred seventy one) euro without VAT  
ALL excluding VAT.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Drejtoria e Tensionit te Larte” OSSH sh.a, ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Objekti i kesaj procedure konsiston ne Riparimin e Transformatoreve te fuqise, magazinimi dhe terheqja sipas nevojave te OSSH sh.a. Vendndodhja e transformatoreve te fuqise per te cilet do te ofrohet ky sherbim eshte ne gjithe territorin e Shqiperise. Operatori Ekonomik, merr persiper transportin e transformatoreve nga vendodhja e tyre deri ne Repartin e riparimit te operatorit ekonomik fitues dhe anasjelltas. Koha per kryerjen e riparimit te transformatoreve nuk do te tejkaloje afatin maksimal prej 30 ditesh kalendarike, nga data e dorezimit te transformatorit ne repart. Kontraktori dhe Autoriteti kontraktor mbajne pocesverbal per konstatimin e difekteve te mundshme te transformatorit te demtuar dhe ne perfundim te kryerjes se sherbimit transformatori i riparuar duhet te jete nenshktruar testeve te matjeve, etj dhe te mbahet akti i kolaudimit.

Ne momentin e dorezimit te transformatorit midis paleve duhet te mbahet edhe proces verbali i dorezimit.

Per sa mesiper dhe per te shmangur shume procese qe mund te lindin, kjo procedure nuk eshte e mundur te ndahet ne lote por duhet te behet nga nje OE per arsye dhe te garancise se defektit.

### **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

*1. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.*

*Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditees ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse nbolancet plotesojne kushtet e parashikuara ne nenin 43/4 te VKm nr. 285.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas të dhënave të QKB-së.*

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti public për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licensat ISO përkatëse, si më poshtë:

- ISO 9001 - 2015 për menaxhimin e cilësisë së punimeve/shërbimeve, ne perputhje me objektin e kontratës; e perditesuar, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- ISO 45001-2018 certifikatë e sistemit të menaxhimit të sigurisë në punë, ne perputhje me me objektin e kontratës; lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

*(shënim-përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe .....

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategoritë e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt i kontratës, duhet të disponojë 1(një) inxhinier elektrik.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Operatorët Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 20 personave të siguar për 3 muajt e fundit

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

*Shënim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është për llogaritur si më poshtë:

**Kërkohen minimumi 20 punonjës, sepse vetë proceset e riparimit janë të tilla që kërkojnë të kalojnë disa faza. Duke qenë se janë pajisje komplekse, kanë nevojë për një sërë specialistësh, duke filluar nga punëtori më i thjeshtë e deri te inxhinieri elektrik që është specialist i fushës. Riparimi kalon në një sërë procesesh të cilat janë: shkarkimi në impiant, çmontimi i pajisjes, konstatimi i defektit, riparimi i defektit, montimi dhe në fund testimi i**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**pajisjes pas përfundimit. Këto procese kërkojnë të paktën jo më pak se 20 punonjës dhe ky numer është percaktuar mbi bazën e perlllogaritjeve të bera për çdo ze pune dhe numrit të oreve të punës që nevojiten për realizimin e tyre.**

*(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës sëshërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).*

- a) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar ose me kontratë shërbimi 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Pajisjet që shërbejnë për kryerjen e të gjitha matjeve komplekse të transformatoreve të fuqisë dhe shpërndarjes nga 1 MVA deri në 80 MVA.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

- Vinç ure ose të levizshëm, për perpunimin tekniko-meknik te transformatorëve me kapacitet mbi 75 ton.

**Arsyetimi:** Vinçi urë nevojitet në këto kapacitete sepse pajisjet që do të riparohen kanë një peshë deri në 80 tonë. Nevojitet për shkarkimin dhe ngarkimin e pajisjeve në automjete si dhe në të gjitha proceset e montimit dhe çmontimit të pajisjeve gjatë riparimit dhe lëvizjes brenda impiantit të riparimit gjatë proceseve të ndryshme si tharja në furrë, çmontimi dhe montimi i aksesorëve, mbushja me vaj etj.

- Makinë për veshjen e telave deri në 8 shtresa letre. (minimumi 1 (një) copë)

**Arsyetimi:** Makina e veshjes së telave me letër kërkohet në rast se një transformator i dëmtuar kërkohet urgjentisht të riparohet. Telat e përdorur në riparimin e transformatorit ndryshojnë në madhësi nga lloji, fuqia dhe tensioni i transformatorit. Transformatorët janë të mbuluar me letër dhe në mungesë të telit i cili ka vonesa për t'u siguruar në vendet e prodhimit, kjo makinë mund të sigurojë sasinë e kërkuar të telit shpejt dhe me efikasitet. Kjo bën të mundur riparimin për një kohë të shpejtë të transformatorit si dhe një zgjidhje efikase për emergjencat.

- Bobinatrice jo më pak se dy copë që thurin bobina me gjatësi deri në dy metër dhe diametër deri në 2.5 m.

**Arsyetimi:** Për thurjen e mbështjelljeve të transformatorit nevojiten makina mbështjellëse, dimensionet e të cilave arrijnë afërsisht 2 metra gjatësi dhe diametër deri në 2,5 m. Nevojiten një minimum prej 2 copë për një riparim më të shpejtë dhe më të sigurt të pajisjeve të dëmtuara, të cilat ofrojnë siguri për vazhdimësinë e punës pa ndërprerje.

- Urë për matjen e koficientit të transformimit - (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Ura për matjen e koeficientit të transformimit është e nevojshme gjatë gjithë procesit të riparimit, si në konstatimin e shpejtë të defektit, gjatë procesit të riparimit ashtu edhe në matjet përfundimtare të cilat duhet të jenë sipas standardeve përkatëse.

- Urë për matjen e rezistencave omike- (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Operatori ekonomik duhet të ketë një urë për matjen e rezistencave omike, të nevojshme për konstatimin e defektit për pajisjet e dëmtuara dhe gjithashtu të nevojshme gjatë procesit të riparimit për të kryer matjet gjatë riparimit. Pas riparimit kryhen matjet përfundimtare të rezistencës omike të pajisjes, të cilat duhet të jenë sipas normave të duhura.

- Urë për matjen e tagent deltës - (minimalisht 1 (nje) cope).



## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Arsyetimi:** Ura e matjes së tagent delta shërben për të treguar izolimin e pajisjes pas përfundimit të riparimit që tregon me saktësi nivelin e izolimit. Kjo është pjesë e protokollit të matjeve përfundimtare të pajisjes. Nivelet e matjes janë sipas normave përkatëse.

- Aparat për matjen e izolimit të pështjellave- (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Pajisja për matjen e izolimit të mbështjelljeve ose ‘meger’, përdoret për matjen e izolimit të mbështjelljeve ndërmjet tyre dhe mbështjelljeve me tokën. Është e nevojshme në të gjitha proceset e riparimit si dhe në matjet përfundimtare.

- Kenotron për matjen e tensionit të shpimit të vajit - (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Kenotroni përdoret për të matur tensionin e shpimit të vajit të transformatorit. Tregon gjendjen e vajit nëse ka lagështi dhe nëse është brenda normave të lejuara. Tregon nëse vaji ka nevojë për trajtim për të hequr lagështinë dhe për ta tharë atë. Tregon edhe gjendjen e vajit në pajisjen që është në funksion nëse vaji është brenda normave. Është gjithashtu një tregues i gjendjes së transformatorit për të parandaluar një defekt.

- Stendë për kryerjen e provës në boshllëk (pa ngarkesë) të transformatorëve të fuqisë - (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Stenda e provës me vakum është një bllok pajisjesh që bën të mundur testimin me tension nominal pa ngarkesë. Çdo transformator gjatë procesit lidhet me tension të rregulluar deri në vlerën nominale të tensionit që ka transformatori. Gjatë lidhjes me hendekun maten rrymat në hendek, të cilat duhet të jenë në parametrat e duhur në varësi të llojeve dhe fuqive të transformatorit. Gjithashtu kryhen teste të tensionit të qarkut të shkurtër, të cilat pasqyrohen në protokollin përfundimtar të matjes. Me këtë stendë kryhen teste mbitensionit dhe maten vlerat e rrymave që kalojnë në transformator.

- Presë vakum filtër për pastrimin dhe heqjen e lagështirës së vajit - (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Kjo pajisje përdoret dhe është shumë e rëndësishme në procesin e riparimit të transformatorëve të naftës. Kjo bën të mundur heqjen e lagështirës nga vaji duke kaluar vajin e nxehtë në një dhomë vakum e cila largon lagështinë. Nga ky proces bëhet heqja e lagështirës së vajit deri në vlerat e kërkuara dhe izolimin e kërkuar. Gjithashtu shërben për pastrimin dhe filtrimin e papastërtive dhe mbetjeve mekanike që ndodhen në vaj.

- Furre vakumi për tharjen e transformatorit - (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Furra me vakum është një dhomë tharjeje në të cilën futen transformatorët e riparuar për tharje dhe mbyllet hermetikisht. Është një dhomë e cila nxehet në një temperaturë të lartë mbi 80 gradë për tharje dhe në të cilën krijohet një vakum midis një pompe vakumi të jashtme.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nëpërmjet vakumit të krijuar, lagështia e transformatorit del jashtë derisa të thahet dhe të arrihen vlerat e duhura të izolimit. Është një furrë shumë efektive për tharjen e transformatorëve.

- Furrë me rezistence dhe qarkullim ajri për tharjen e transformatorit - (minimalisht nje cope).

**Arsyetimi:** Furra e qarkullimit të ajrit të nxehtë është një dhomë në të cilën futen transformatorët e riparuar për tharje. Parimi i punës është qarkullimi i ajrit të nxehtë brenda kësaj dhome në një temperaturë mbi 80 gradë. Kjo bën të mundur që transformatorët të thahen në vlerat e duhura të izolimit. Dimensionet e këtyre dhomave janë të tilla që transformatorët e riparuar mund të hyjnë lirshëm.

- Urë për matjen e rrymave te rrjedhjes (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Ura për matjen e rrymave të rrjedhjes është e nevojshme për të treguar që parametrat e izolimit të arritur nga riparimi i pajisjes të jenë në nivelet e duhura. Tregon nivelet e izolimit të vorbullës me trupin dhe është pjesë e protokollit përfundimtar të matjes.

- Pajisje për saldimit e përcjellësave prej bakri dhe atyre prej alumini (minimalisht 1 (nje) cope).

**Arsyetimi:** Këto pajisje janë të nevojshme për faktin se mbështjelljet e transformatorit janë kryesisht prej bakri ose alumini dhe procesi i saldimit është kyç në riparimin e transformatorit.

- Kamion vinç me peshe ngritese jo me te vogel se 50 ton. (minimalisht 1 (nje) cope) - në pronësi ose me qira, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës : Akt pronësie ose kontrate qeraje, shoqëruar me Leje Qarkullimi, Kontrolli Teknik Periodik, Siguracion, foto.

**Arsyetimi:** Këto pajisje ngritëse dhe transportuese kërkohen për të lëvizur transformatorët drejt impiantit ose anasjelltas. Meqenëse pesha e transformatorëve arrin deri në 50 tonë, për lëvizjen e tyre nevojitet një vinç i veçantë me aftësi ngritëse. Këto duhet të dokumentohen siç duhet, sepse mund të zhvendosen në çdo kohë dhe gjithashtu për raste urgjente.

Dokumentet e pronësisë duhet të dorëzohen që pajisjet e mësipërme të plotësojnë këto kërkesa referuar specifikimeve teknike. Për pajisjet për të cilat operatorët nuk disponojnë dokument pronësie, ofertuesi duhet të paraqesë një faturë tatimore, ose deklaratë doganore, të shoqëruar me fotografi, ose një deklaratë noteriale që deklaron zotërimin e këtyre pajisjeve, shoqëruar me fotografi.

Për mjetet dhe pajisjet e sipërpërmendura duhet të deklarohet vendndodhja e tyre dhe Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë verifikime për pajisjet / veglat / makineritë e mësipërme në çdo kohë.

**Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

Për mjetet që janë në pronesi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).*

**2.3.5** Për realizimin e kontratës, operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë ambiente pune dhe shërbimi me qera ose ne pronesi me sipërfaqe jo më të vogël se 4000m<sup>2</sup> nga të cilat:

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

Ambiente te mbuluara min 2000 m<sup>2</sup> dhe lartesi  $\geq$  12m, per sherbimet e riparimit tekniko-mekanike te trasformatoreve te fuqise dhe shperndarjes, dhe 2000 m<sup>2</sup> sipërfaqe e hapur shesh per manovrim dhe ngarkim shkarkimin e trasformatoreve dhe pjeseve te kombimit.

**Arsyetimi:** Sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> e mbuluar per vendosjen e makinerive dhe paisjeve te kerkuara si pjese integrale e procesit te riparimit te trasformatoreve.

Sipërfaqe per perpunimin e transformatorit si montim-cmontimin, ndërrim të vajit, furrat e tharrjes, bobinatricet, makinerite salduese, sipërfaqet testuese me ngarkese, te cilat kerkojne hapësirat e nevojshem te punes dhe zbatimin e rregullave te sigurimit teknik.

Vend te rendesishem ze edhe Vinci Ure, si paisje kryesore per riparimin e trasformatoreve. Hapesira kerkohet gjithashtu per depozitat e vajit, vaskat e ujit, ambientet per magazinimi e pjeseve te kembimit, etj.

Sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup> si shesh i pa mbuluar per perpunimn e trasformatoreve, ngarkim-shkarkimin e tyre si dhe pjeseve te kembimit, depozitat e vajit, ambiente per magazinimi te materialeve te demontuara dhe materialeve te reja etj.

*Te dy sipërfaqet e sipercituara jane perlllogaritur mbi bazen e sipërfaqes minimale te nevojshme, per realizimin e proceseve te punes te parashikuara ne kontrate, duke pasur parasysh edhe mjetet, pajisjet dhe makinerite e domosdoshme per realizimin e secilit proces, sipas radhes teknologjike te kryerjes se tyre.*

*Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1.....**  
.....

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit*

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

*publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, ndërsa kriteret ligjore janë vendosur nga anëtarët e njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **15/12/2023**, ora 10:00.

**❖ Njesia e Prokurimit**